



Pranimi / Doretuar Prilbena / Prilbena Received / Delivered	30-09-2022	2	viti / god. year
Organ / Njësia Org / Unit	Di / Prof Di / Prof	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Koliciteti Quantity
SKIMSHICKA	5795/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.685/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Malsore Gashi - Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj -Demi,anëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.685/2022 të datës 03.08.2022, të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi:

nga Komuna e Kamenicës, kundër organit të punësimit Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike „kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.09.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.685/2022 e datës 03.08.2022 e parashtruar nga ankuesi ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Kamenicës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Kamenicës me datë 03.08.2022, me numër protokoll 4499/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 22530, të datës 19.07.2022, të Menaxherit të Personelit në Komunën e Kamenicës me pretendimet ankimore se institucionin punëdhënës është duke vepruar jashtëligjshëm ngase nuk po i'a mundëson kthimin në punë sipas akt emërimit të datës 19.07.2018 respektivisht as nuk është duke ia aprovuar kërkesën për pushim pa pagesë për shkaqe shëndetësore të anëtarit të familjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 05.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Kamenicës. Ndërsa me datë 19.08.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë dhe po ashtu me datë 26.09.2022 ka Këshilli ka pranuar provat shtesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 685/2022, e datës 03.08.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e-maili i datës 01.12.2021; Vendimi i datës 21.04.2022, A. Nr. 237/2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e-maili i datës 04.03.2021; Kërkesa e datës 02.12.2021, për pushim; Vendimi i datës 11.02.2022, i Komisionit Disiplinor; Vendimi me numër protokoll 22530 i datës 19.07.2022; Akt Emërimi i datës 19.07.2018; Kërkesë e datës 10.04.2019, me numër protokoll 102225; Vendimi i datës 10.04.2019; me numër protokoll 10265; Kërkesë e datës 18.01.2022, për sqarim; Kërkesë e datës 20.01.2022, me numër protokoll 1892; Kërkesë e datës 22.11.2022 për pushim pa pagesë; Përgjigje në ankesë e datës 19.08.2022, me numër protokoll 4825/2022, me shkresat e bashkangjitura; E-mailin e datës 26.09.2022 dërguar nga B. K për Këshillin me korrespondencën e bashkangjitur prej tre faqesh; Listën e pagave për periudhën dhjetor 2021 deri në muajin gusht 2022; E-mailin datës 04.04.2022 dërguar nga ankuesi për B.K dhe A.M; E-mailin e datës 01.06.2022 dërguar nga ankuesi për Kryetarin e Kamenicës;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të administrativit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankuesi sipas aktit të emërimit të datës 19.07.2018 pas përfundimit të procedurave të rekrutimit është emëruar në pozitën "Zyrtar për Rini" në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte të Komunës së Kamenicës, ndërsa ende pa e përfunduar periudhën provuese prej dymbëdhjetë (12) muajsh respektivisht pa iu konfirmuar emërimi në detyrë siç përcaktohej me dispozitat e ligjit material sikurse edhe përmbajtjes së aktit të emërimit të datës 19.07.2018 të cilin ankuesi e ka pranuar dhe nënshkruar me datë 20.07.2018, i njëjti ka parashtruar kërkesë për pezullimin e dakorduar të

vendit të punës në shërbimin civil me datë 10.04.2019 pran kryetarit të Komunës së Kamenicës, ndërsa kryetari i Komunës së Kamenicës me datë 10.04.2019 përmes Vendimit me numër:10265 ka nxjerrë vendimin për pezullimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil duke e emëruar të njëjtin Shef të Kabinetit në Zyrën e Kryetarit të Komunës, ndërsa në pikën 3 të dispozitiv të këtij vendimi është vendosur që nëpunësi civil pas përfundimit të mandatit politik ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme.

Ankuesi me datë, 22.11.2021 kishte parashtruar kërkesë për pushim pa pagesë prej një (1) viti nga data 01.01.2022 deri me datë 31.12.2022, kërkesë kjo e cila është parashtruar nga cilësia e pozitës së Shefit të Kabinetit të Zyrës së Kryetarit me arsyetimin se e ka të nevojshme të kujdeset për shëndetin e anëtarëve të familjes (*shkresë kjo e cila nuk është mbështetur me dëshmi provuese*) si dhe duke potencuar që me rastin e përfundimit të mandatit të Kryetarit të Komunës, ankuesi do të kthehej në pozitën "Zyrtar për Rini" sipas aktit të emërimit, mirëpo ankuesi përveç kësaj kërkesë me datë 02.12.2021 ka parashtruar edhe një kërkesë për pushim vjetor deri me datë 05.01.2022 në cilësi të Shefit të Zyrës së Kryetarit. Po ashtu, ankuesi në cilësi të provave ka sjellë një e-mail të datës 01.12.2021 të dërguar në adresë të zyrtarit N. R të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Kamenicës me kërkesën që i njëjti të lirohet nga detyra e Shefit të Kabinetit të Kryetarit dhe rikthimin në pozitën "Zyrtar për Rini", po ashtu ankuesi me datë 11.01.2022 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore përmes e-maili me kërkesën për dhënien e informatave sqaruese lidhur me paraqitja e kërkesës për pushim të datës 22.11.2021 me arsyetimin se me datë 06.01.2022 kanë kaluar 45 ditë si afat ligjor për të nxjerrë aktin sipas kërkesës së palës në kuptim të Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative.

Ankuesit, i ishte iniciuar procedurë disiplinore për shkak të mungesës në punë nga U.D së Drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport, mirëpo Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenicës përmes vendimit më numër:01/2022 të datës 11.02.2022 e kishte refuzuar kërkesën e iniciueses së procedurës disiplinore me arsyetimin se ankuesi ka parashtruar dy kërkesa për pushim, njëren me datë 22.11.2021 për pushim pa pagesë nga data 05.01.2022 deri me datë 31.12.2022 gjegjësisht kthimin në pozitën paraprake në pozitën sipas aktit të emërimit, si dhe kërkesën tjetër të datës 02.12.2021 për pushim nga data 03.12.2021 deri me datë 05.01.2022, dhe po ashtu Komisioni Disiplinor kishte konstatuar se ankuesi është i përfshirë në listën e pagave, çka nënkupton sipas tyre se ankuesi është kthyer juridikisht në pozitën e shërbyesit civil sipas aktit të emërimit, ndërsa e kishte detyruar Njësinë e Burimeve Njerëzore të shqyrtojë kërkesën e ankuesit të datës 22.11.2021 për pushim pa pagesë respektivisht edhe kthimin faktik me detyra dhe përgjegjësi në pozitën e mëparshme.

Në mungesë të ndërmarrjes së veprimeve nga ana e Komunës së Kamenicës, ankuesi me datë 04.04.2022 i drejtohet sërish Njesisë së Burimeve Njerëzore me njoftimin se i njëjti është duke u pagur dhe vazhdon të paguhet pa shkuar në punë sikurse kërkon që të zbatohet Vendimi më numër:01/2022 i Komisionit Disiplinor i datës 11.02.2022 sipas të cilit ishte obliguar Njësia e Burimeve Njerëzore që të shqyrtojë kërkesën e ankuesit të datës 22.11.2021 për pushimin pa pagesë dhe ri-kthimin e tij në pozitën e mëparshme të punës. Po ashtu, ankuesi me datë 01.06.2022 i drejtohet Kryetarit të Komunës me njoftimin se të njëjtit vazhdon t'i bëhet paga pa punuar fare sikurse e vë në dijeni se është në pushim me pretendimin se kërkesa e tij është aprovuar në heshtje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 19.07.2022 ka nxjerrë vendimin me numër:22530 përmes të cilit e largon ankuesin nga lista e pagave deri në përfundimin e procedurës lidhur me kërkesën e datës 22.11.2021, ndërsa ankuesin e obligon që të kthej në xhirollogarinë bankare të Komunës të gjitha mjetet e pranuar pa punuar që nga data 03.12.2021 deri me datë 30.06.2022 në vlerë prej 2,980.11€, ndërsa në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesi propozon që Këshilli të marr vendim me qëllim të anulimit të Vendimit me numër:22530 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 19.07.2022, të obligohet Kryetari i Komunës që të zbatojë pikën 1 dhe 3 të Vendimit të datës 10.04.2019 duke ia mundësuar ankuesit kthimin e tij në vendin e punës sipas aktit të emërimit në pozitën "Zyrtar për Rini" si dhe kërkon të respektohet pika II e Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 11.02.2022 sipas të cilit ishte obliguar Njësia e Burimeve Njerëzore të shqyrtojë kërkesën e ankuesit të datës 22.11.2021 për pushim pa pagesë. Po ashtu në bazë të listës së pagave, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi pavarësisht që nuk ka qenë duke e vijuar procesin e punës, i njëjti është paguar në baza mujore për muajin dhjetor 2021, si dhe muajt janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor dhe korrik 2022 në vlerën prej 425.73€uro në muaj.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës sikurse dhe pasqyrimin të gjendjes faktike, ka konstatuar se e gjithë situata e krijuar me paqartësitë procedurale lidhur me të gjitha kërkesat e parashtruara nga pala ankuese, gjegjësisht njohja e të drejtës ose jo e ankuesit për tu kthyer në vendin e punës sipas aktit të emërimit, sikurse dhe përfshirja e ankuesit në listën e pagave është ardhur si rezultat i paqartësive dhe mungesës së ushtrimit të autoritetit dhe funksionit vendimmarrës nga ana e organeve drejtuese të Komunës së Kamenicës sikurse përcaktohet dhe kanë qenë të obliguara të vepronë bazuar në nenin 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 4 paragrafi 1 si dhe nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase pavarësisht që ankuesi ka bërë dy (2) kërkesa për pushim njëren me datë 22.11.2021 si dhe tjetren me datë 02.12.2021, sikurse edhe kërkesën e të datës 01.12.2021 i cili kishte kërkuar që të lirohet nga detyra dhe rikthimin e tij në pozitën sipas aktit të emërimit dhe institucioni punëdhënës respektivisht Komuna e Kamenicës nuk ka vepruar, gjegjësisht nuk e ka formësuar vullnetin e organit publik në realizimin e autoritetit publik duke manifestuar veprime administrative apo duke nxjerr akte konkrete lidhur me kërkesat e palës në procedurë, madje mbetet e pakuptueshme se mbi çfarë bazë ankuesi ka mbetur pjesë e listës së pagave apo është futur në listë të pagave, përderisa nuk ka një akt administrativ të shkruar mbi bazën e të cilit ankuesit i është konfirmuar kthimi në detyrë sipas aktit të emërimit të datës 19.07.2018.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Vendimi i datës 10.04.2019, përmes të cilit ankuesi ishte emëruar Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës në pikën 1 të dispozitivit nuk ka përcaktuar qartë afatin apo datën deri kur i njëjti prodhon efekte juridike, sikurse Njësia e Burimeve Njerëzore nuk i është përgjigjur kërkesë së ankuesit të datës 01.12.2021 i cili kishte kërkuar që të lirohet nga detyra dhe të rikthehet në pozitën e tij sipas aktit të emërimit, andaj mbi këtë bazë ankesa e ankuesit aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe lënda e ankuesit kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje, ndërsa Kryetari i Komunës së Kamenicës në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ, në mbështetje të nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për

Procedurën e Përgjithshme Administrative është i detyruar të shfuqizojë Vendimin e datës 10.04.2019 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës përmes të cilit ankuesi ishte emëruar Shefi i Kabinetit të Kryetarit, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore është e obliguar që ta trajtojë dhe shqyrtojë kërkesën e ankuesit të datës 01.12.2021 për lirim nga detyra e Shefit të Kabinetit të Kryetarit dhe ri-kthimin në pozitën e punës sipas aktit të emërimit, gjegjësisht konfirmimin ose jo të aktit të emërimit.

Lidhur me pretendimet e ankuesit sipas të cilave kërkohet që Këshilli të obligojë Njësinë e Burimeve Njerëzore të shqyrtojë kërkesën e datës 22.11.2021 lidhur me kërkesën për pushim pa pagesë, nuk mund të aprovohet ngase kërkesa e tillë është bërë me synim të realizimit të pushimit pa pagesë nga data 05.01.2022 deri me datë 31.12.2022 dhe se në masë të madhe ky pushim faktikisht pothuajse është konsumuar, sikurse nuk mund të shqyrtohet një kërkesë për pushim pa pagesë duke u thirrur në dispozitat e ligjit material për shërbyesit civil përderisa në momentin e parashtrimit të kësaj kërkesë me datë 22.11.2021 ankuesi e ka pasur të pezulluar marrëdhënien e punës nga shërbimi civil, mirëpo ankuesit nëse i konfirmohet ose jo akti i emërimit, i njëjti mund të parashtrrojë kërkesë për pushim pa pagesë, mirëpo çdo herë duke i përfillur parakushtet ligjore si dhe duke plotësuar dhe dëshmuar kërkesat e njëjta siç përcaktohet me dispozitat e ligjit material, ligjit të punës dhe Rregullores Nr.06/2020 për Pushimet e Nëpunësve Civil.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës dhe konstatimit të gjendjes faktike ka ardhur në përfundimin se pika 2 e dispozitivit të Vendimit me numër:22530 të datës 19.07.2022 i Njesisë së burimeve Njerëzore është ligjërish e bazuar pasi që në kuptim të nenit të Ligjit të Pagave, ankuesi del të këtë përfituar jashtëligjshëm pagën në baza mujore respektivisht ky përfitim ka qenë në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: *“Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave”*, pasi që ankuesi nuk ka vijuar punën në mënyrë të rregullt, andaj mbi këtë bazë ankuesi obligohet që të kthejë të gjitha pagat në llogarinë e Komunës së Kamenicës të cilat janë përfituar në emër të marrëdhënies së punës në periudhën kohore nga data 03.12.2021 deri me datë 31.07.2022 të evidentuar sipas listës së pagave. Mirëpo, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ky përfitim i jashtë ligjshëm i pagës ka qenë pa fajin e ankuesit pasi që i njëjti me datë 04.04.2022 i ka njoftuar Njësinë e Burimeve Njerëzore, sikurse e ka njoftuar edhe Kryetarin e Komunës së Kamenicës përmes e-mailit të datës 01.06.2022 si dhe Agjencinë Kundër Korrupsion me datë 13.07.2022 se është duke përfituar pagë në baza mujore në të njëjtën kohë përderisa është në pushim pa pagesë me pretendimin si i është aprovuar në heshtje.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej

tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR. 685/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Malsore GASHI - BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Kamenicës;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës, dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*